



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:227669
Datë: 07.02.2025
Numri i dokumentit: 06818207

C.nr.4360/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridiko kontestimore të paditësve: A.Q., H.Q., R.Q. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Y.K. nga Prizreni, E.H. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Xh.E. nga Prizreni, kundër të paditurve B.R. nga Prizreni, Sh.Q., S.K. dhe F.Q. të gjithë nga Petrova, komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson avokati R.B. nga Prizreni dhe I.D. nga Prizreni, për shkak të kontestit vërtetim i pronësisë, jashtë seancës, me datë 07 shkurt 2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia së bashku me propozimin për caktimin e masës së sigurisë e paditësve A.Q., H.Q., R.Q., A.Sh. dhe E.H. që të gjithë nga Prizreni, e parashtruar ndaj të paditurve B.R., Sh.Q., S.K., F.Q. dhe I.D. që të gjithë nga Prizreni, në këtë çështje juridike kontestimore, **si e palejuar**.

A r s y e t i m

Fillimisht pranë kësaj gjykate paditësit H.Q., H.Q. dhe E.Q. nga Prizreni, përmes të autorizuari të tyre Y.K. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 30.09.2019, kanë parashtruar padi, kundër të paditurve B.R. nga Prizreni, lagjja dhe Sh.Q., S.K. dhe F.Q. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson R.B. avokat nga Prizren, për shkak të çështjes juridike me objekt kontesti vërtetim pronësie. Ndërsa me parashtrësën e datës 06.09.2023, gjykatës ia ka paraqitur propozimin për caktimin e masës së sigurisë, në këtë çështje juridike kontestimore.

Gjykata me aktvendimin me shenjë C.nr.1570/2019, të datës 03.11.2023, e ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të vdekjes së të paditësve H.Q. dhe H.Q. ish nga Prizreni.

Me parashtresën e datës 22.11.2023, i autorizuari i paditësve avokat Y.K. ka propozuar vazhdimin e procedurës së ndërprerë me paditës A.Q., H.Q., R.Q., A.Sh., dhe E.H. që të gjithë nga Prizreni, ndaj të paditurve B.R., Sh.Q., S.K., F.Q. dhe I.D. që të gjithë nga Prizreni.

Gjykata ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me caktimin e masës së sigurisë me datë 16.04.2024, në të cilën kanë prezantuar R.Q. personalisht si dhe i autorizuari Y.K. avokat nga Prizreni, paditësja E.Q. si dhe i autorizuari Av. Xh.E. si dhe i autorizuari i të paditurve R. . avokat nga Prizreni.

I autorizuari i të paditurve avokat R.B. në seancën e datës 16.04.2024 dhe përgjigjen e paraqitur me datë 07.05.2024, ka theksuar se çështja e cila është iniciuar për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, për pjesën ideale si në padi, është vendosur me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr. 860/90, të datës 08.11.1990, ashtu që kjo është çështje juridike e gjykuar. Sipas këtij aktgjykimi paditësve të paraqitur paraprakisht me padi H., H. dhe E.Q. iu është pranuar e drejta e bashkëpronësisë dhe atë të gjithë këtyre në pjesën ideale 3/12, të paluajtshmërive kontestuese nga padia në këtë çështje juridike për të cilën është caktuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit. Nuk është e vërtetë që çdo njërit nga të paraqiturat e mësipërm apo secilit prej tyre iu është pranuar e drejta e pronësisë me pjesën ideale 3/12. Në bazë të aktgjykimit të lartshënuar të plotfuqishëm është iniciuar procedura për ndarje fizike të paluajtshmërisë nga ky aktgjykim i plotfuqishëm, e cila paluajtshmëri është edhe objekt i këtij kontesti të iniciuar, ashtu që me aktvendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të Prizrenit, me nr. NDR.NR.677/92, të datës 19.01.1993, është bërë ndarja fizike e atyre paluajtshmërive ashtu që edhe çdo njëri nga palët ndërgjyqëse sipas këtij kontesti i kanë marrë pjesët e veta. Pas kësaj në ndër kohë ka vdekur bashkëshorti përkatësisht i tre të paditurve të fundit nga e cila arsye është zhvilluar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së A.Q. ashtu që janë shpallur trashëgimtar tre të paditurit e fundit.

Në lidhje me këtë çështje, e duke u thirrur në theksimet e të autorizuarit të paditësve dhe të të paditurve të dhëna në padi dhe në përgjigjen e datës 07.05.2024, gjykata ka bërë shikimin në shkresat e lëndës e sidomos në aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr. 860/90, të datës 08.11.1990, i plotfuqishëm nga data 04.02.1991 dhe aktvendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të Prizrenit, me NDR.NR.677/92, të datës 19.01.1993, me ç'rast edhe u konstatua se në këtë çështje kontestimore, kemi të bëjmë me çështjen e gjykuar – res judicata, ngase për këtë çështje dhe ndërmjet këtyre palëve, tani më është vendosur nga ana e kësaj gjykate. Përkatësisht me

aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr. 860/90, të datës 08.11.1990, i plotfuqishëm nga data 04.02.1991, gjykata ka vërtetuar faktin se paraardhësit e këtu paditësve H., H. dhe E.Q. kishin paraqitur padi ndaj paraardhësve të këtu të paditurve, dhe se Gjykata Komunale në Prizren e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve- paraardhësve të tani të paditësve, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë duke ia njohur të drejtën e pronësisë në 3/12 pjesë të pronës në ngastrat kadastrale si në këtë aktgjykim. E po ashtu me aktvendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të Prizrenit, me NDR.NR.677/92, të datës 19.01.1993, është bërë ndarja fizike e paluajtshmërisë e cila është objekt kontesti në këtë çështje juridike kontestimore. Pas konstatimit të këtij fakti, paditësit të drejtën të cilën kërkojnë ta realizojnë përmes gjykatës, e drejt e cila ju derivon nga paraardhësi e tyre, e kundër të cilit tashmë kemi një aktgjykim të plotfuqishëm, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 391 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4360/2023, 07 shkurt 2025

G j y q t a r i

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.